




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Ref: 1907/943/KPM/mf

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 1 dhe paragrafin 2 pika 6 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, në takimin e mbajtur me datë 24 korrik 2019, mori këtë:

### VENDIM

SHFUQIZOHET Vendimi Nr. 1906/783/KPM/mf përmes të cilët janë përjashtuar nga lista e bartjes se obligueshme Ofruesit e Shërbimeve Mediale të cilët transmetojnë jashtë rrjetit tokësorë të transmetimit (jashtë brezit frekuencor)


### ARSYETIM

KPM, me datë 24 qershor 2019, duke u bazuar në kërkesën me shkrim nga Oda Ekonomike e Kosovës përmes të cilës ka kërkuar nga KPM të inicohet procedura e ndryshimit të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01, ka nxjerr vendim për ndryshimin e listës së kanaleve për bartje të obligueshme.

KPM, pas analizimit të kërkesave të palëve të atakuar me këtë vendim si dhe duke u bazuar në vetë kërkesën e Odës Ekonomike të Kosovës përmes të cilës është kërkuar ndryshimi i Rregullores KPM-2016/01, konsideron se çështja e përjashtimit nga bartja e obligueshme të Ofruesve të Shërbimeve Mediale të cilët transmetojnë jashtë rrjetit tokësorë të transmetimit, duhet adresuar dhe rregulluar përmes ndryshimit dhe plotësimit të Rregullores KPM 2016/01.

KPM, me qëllim të adresimit të kërkesës së Ofruesve të Shërbimeve Mediale për përjashtim nga bartja e obligueshme, ka themeluar grupin punues për iniciimin e ndryshimit të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

  
Muja FERATI  
Kryetar  
Komisioni i Pavarur i Mediave



25.07.2019  
data